

## Vendim nr. 309 datë 18.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marjana Semini, Anëtare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 18.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (J) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** JOVAN VASILI, përfaqësuar nga avokat Envi Hicka, me prokurë

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5634 (710), datë 06.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i cenimit të afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e kërkesës për kthimin dhe/ose kompensimin e pronës së trashëgimlënësit U.V. Rivendosja e së drejtës së pronës së kërkuarit duke vendosur antikushtetutshmërinë e urdhrave për rishikimin e së drejtës së kthimit të pronës nga ish-drejtori i AKKP-së. Shpërblimi i kërkuarit për shkeljen e afateve të arsyeshme të gjykimeve.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 1384, datë 22.12.2000, ka vendosur njohjen e pronësisë së trashëgimtarëve të një subjekti të shpronësuar mbi një tokë bujqësore të ndodhur në Bashkinë Fier (ish-komunat Dërmenas dhe Levan). Megjithëse vendimi ka marrë formë të formë të prerë, ai nuk është ekzekutuar.

2. Në këto rrethana, kërkuesi, në cilësinë e njërit prej trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, ka aplikuar në ish-Komisionin për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (*KKKP*). Ky i fundit, me vendimin nr. 54 të vitit 2001, ka vendosur vetëm njohjen e pronësisë për sipërfaqen 8491 dynym tokë bujqësore, por pa ia kthyer ose kompensuar atë për shkak se ligji i kohës nuk e lejonte.

3. Në vitin 2008 trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar kanë kërkuar rishikimin e vendimit dhe kthimin fizik të pronës, me argumentin se ligji kishte ndryshuar. Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*ZRKKP*) të qarkut Fier, me vendimin nr. 291, datë 08.05.2008, ka vendosur njohjen e së drejtës së kthimit fizik të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 66.88 ha trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar dhe kompensimin e tyre për sipërfaqen e tokës bujqësore prej 33.1 ha.

4. Drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*AKKP*) pas 4 muajve e ka marrë në shqyrtim kryesisht vendimin e *ZRKKP*-së, Fier dhe me vendimin nr. 999, datë 05.09.2008 ka vendosur shfuqizimin e tij dhe kthimin për rishqyrtim me detyra të përcaktuara.

5. *ZRKKP*-ja, Fier, pas rishqyrtimit, me vendimin nr. 125, datë 10.03.2009, ka vendosur të mos njohë të drejtën e kthimit fizik për sipërfaqen e tokës bujqësore prej 66.8 ha në emër të trashëgimtarëve ligjorë, përfshirë kërkuesin, të subjektit të shpronësuar. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në *AKKP*, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit dhe kthimin e pronës.

6. Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) kishte marrë në shqyrtim ndryshimet ligjore për kthimin dhe kompensimin e pronës dhe në datën 26.09.2011 ka vendosur shfuqizimin e disa dispozitave. Ajo ka vlerësuar se titujt e pronësisë të fituar me anë të vendimeve të ish *KKKP*-ve nuk mund të anulohen apo shfuqizohen *iure imperi*, pra në mënyrë të njëanshme, me anën e vendimeve administrative të nxjerra nga autoritetet publike përkatëse, në rastin konkret të drejtorit të *AKKP*-së. Ushtrimi i një kompetencë të tillë shfuqizuese krijon

një gjendje pasigurie juridike, e cila nuk mund të korrigojohet me zgjidhje që imponojnë veprime po aq të pasigurta, të cilat nuk garantojnë kthimin në ligjshmëri (*shih vendimin nr. 43, datë 26.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës, AKKP-ja ka deklaruar mungesën e juridiksionit dhe kompetencës së saj, duke orientuar kërkuesin t'i drejtohej gjykatës. Në këto rrethana, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë për shfuqizimin e vendimeve të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së dhe të ZRKKP-së, si dhe kthimin fizik të pronës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11199, datë 08.11.2013, ka vendosur pranimin e padisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të kundërshtuara. Ndonëse AKKP-ja dhe Avokatura e Shtetit kanë paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 570, datë 03.03.2015. Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP), së cilës i kanë kaluar me ligj të drejtat dhe detyrimet e AKKP-së, ka paraqitur rekurs.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5634 (710), datë 06.12.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të dytë, me arsyetimin se gjykatat e faktit nuk kanë kuptuar drejt natyrën e mosmarrëveshjes, si dhe kanë zbatuar gabim ligjin lidhur me fuqinë prapavepruese të vendimeve të Gjykatës. Po ashtu, sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit nuk kishte marrë vendim të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës së kërkuesit për shtimin e objektit të padisë.

9. Në datën 26.10.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000 dhe është regjistruar në datën 05.11.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

10.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

10.1.1. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë duhet të kishte ushtruar funksionin e saj si gjykatë ligji duke dhënë një zgjidhje përfundimtare për këtë çështje, për sa kohë që shkelja e konstatuar është me natyrë teknike-juridike. Gjykata e Lartë përmend mungesën e vendimit të ndërmjetëm për shtimin e shkakut të padisë, por kjo shkelje nuk përfshihet në ato të parashikuara nga neni 467 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Për më tepër, palët e paditura nuk e kanë ngritur kurrë këtë

pretendim, për pasojë ai ka rënë në dekadencë dhe nuk mund të vlerësohej më nga Gjykata e Lartë. Duke prishur vendimin për një shkak të paparashikuar nga neni 467 i KPC-së, ajo gjykatë ka vendosur për një çështje që nuk ishte objekt i shqyrtimit përpara saj.

10.1.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi organet administrative dhe gjyqësore në rastin e kërkuarit nuk kanë zbatuar vendimet e Gjykatës lidhur me të drejtën e drejtorit të AKKP-së për ushtrimin e nismës dhe shfuqizimin e vendimit që i kthente pronën kërkuarit dhe trashëgimtarëve të tjerë të subjektit të shpronësuar. Drejtori i AKKP-së e shfuqizoi vendimin jashtë afatit ligjor, në kushtet kur vendimi ishte përfundimtar dhe i pakundërshtueshëm.

10.1.3. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi që nga momenti kur trashëgimtarët fituan gjyqin për t'u njohur pronarë, kanë kaluar 24 vjet dhe e drejta e tyre e pronës ende nuk është rivendosur. Gjykata e Lartë, duke e kthyer çështjen për rigjykim, e ka tejzgatur edhe më shumë këtë afat, duke i mohuar kërkuarit dhënien e drejtësisë, si dhe ka provuar se është një mjet joefektiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

10.2. *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 të Kushtetutës, për shkak të cenimit të procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ndonëse kërkuari dhe trashëgimtarët e tjerë të subjektit të shpronësuar fituan në vitin 2005 një pasuri të paluajtshme, e cila është e regjistruar edhe sot në emrin e tyre, në vitin 2008 u vendos shpronësimi faktik i tyre, përtej interesit publik dhe pa shpërblim, si dhe në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe

rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në vështrim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

13. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

14. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin *subsidiar* që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, kjo do të thotë se mund të kërkoet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se vendimet gjyqësore që kthejnë çështjen për rigjykim nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjykimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimin nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen konkrete, kërkuesi në objektin e ankimit kushtetues individual ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të datës 06.12.2023 të Gjykatës së Lartë, me të cilin çështja e tij është kthyer për rigjykim në gjykatën e apelit. Kolegji çmon se në kushtet kur çështja është kthyer për rigjykim dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e saj nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kërkuesi ka ende mjete ligjore në dispozicion për të paraqitur pretendimet e tij për të drejtat që pretendon se i janë shkelur, prandaj kërkesa nuk plotëson kriterin për shterimin e mjeteve juridike efektive.

16. Gjithashtu, kërkuesi ka kërkuar edhe konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes së kthimit dhe/ose kompensimit të pronës, me argumentin se ndonëse kanë kaluar 24 vjet e drejta e pronës së tyre ende nuk është rivendosur. Sipas kërkuesit, gjykimi në Gjykatën e Lartë ka zgjatur 8 vjet dhe kthimi i çështjes për rigjykim në shkallë të dytë e tejzgjat edhe më shumë kohën e çështjes së tij.

17. Lidhur me këtë kërkim, Kolegji sjell në vëmendje se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se këto mjete ligjore për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Bazuar në standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete, Kolegji konstaton se kërkuesi i ka pasur të gjitha mundësitë t’i drejtohej drejtpërdrejt Gjykatës përpara datës 05.11.2017 me kërkesë për konstatimin e shkeljes, ndërsa pas kësaj date Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave, ndërkohë që nuk rezulton që ai të ketë paraqitur ndonjë kërkesë të tillë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këtë kërkim kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion dhe, rrjedhimisht, ai nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Për sa më lart, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohej Gjykatës dhe se në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

20. Si përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.